



## P R O C E S V E R B A L I

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **27.03.2015** me fillim në ora 10. Të pranishëm: Delegatët e Kuvendit, Nënkyryetari i komunës dhe drejtoret e drejtive, Komandanti e Stacionit policor në Rahovec Osman Ismajli, përfaqësuesit e OSBE-së, Lmt, monitoruesi i KDI-së, përfaqësuesit e mediave dhe të tjera. Mbledhjen e ka kryesuar **Nahit Elshani**, kryesuesi i Kuvendit dhe pasi ka përvendetur të pranishmit, për mbledhjen e sotme ka propozuar këtë:

### Rend Dite

- 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Informimi mbi punën e stacionit Policor në Rahovec për vitin 2014,( informimin do të bëjë komandanti i Policor)**
- 3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për organizimin e brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratës të komunës së Rahovecit,**
- 4. Shqyrtimi dhe aprovimi o propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e pronës private për nevojat e shkollës filllore "Ardhmëria" në Rahovec,**
- 5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për shlyerjen e borxheve 50% e të gjithë qiramarrësve të pasurisë komunale,**
- 6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës të OJQ "EKSODI 99",**
- 7. Shqyrtimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa,**
- 8. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve,**

**Kryesuesi –** Delegat të nderuar kisha kërkuar nga ju mirëkuptim që në këtë seancë të jetë edhe një herë si pikë e rendit të ditës Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa, kjo rregullore ka kaluar në Kuvendin e komunës, por nuk është bërë certifikimi i saj për shkak se disa drejtori nuk i kanë harmonizuar taksat, tarifat dhe ngarkesat me taksat e përcaktuar nga niveli qendror.

**Fatmir Iska –** Ne kemi pasur KPF para dy jave dhe kemi dalë me disa rekomandime që nuk po respektohen dhe po krijohet një praktikë jo e mirë, ne kemi kërkuar për pikën e 5 që të na vije një listë e atyre qiramarrësve që kanë borxhe ndaj komunës, në mënyrë që të kemi të qartë sa janë dhe sa do t' i falet borxhi. Kërkoi nga ju kryesues që ta qitni në votim dhe të hiqet si pikë e rendit të ditës kjo pikë ngaase nuk na është ofruar kjo listë. Sa i përket pikës 4 nuk e kemi fletën poseduese në mënyrë që të tregoj ma qartë se kush është pronar i asaj prone. Sa i përket pikës shtesë të rendit të ditës lidhur me Rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba ne si grupi i AAK-së jemi kundër që të futet si rend i ditës për arsy se mendojmë se duhet të kaloj në KPF.

**Kryesuesi –** Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa nuk ka pas nevojë të kaloj në KPF, po ashtu nuk e kemi pas konfirmimin e ligjshëmrisë nga ana e MAPL dhe për atë arsy e kemi qitë sot dhe drejtori sot duhet vetëm t'i tregojë ndryshimet e bëra dhe ku ka pas mos harmonizim me nivelin qendror. Listën e borxhlinjeve e keni tash, po ashtu edhe një vërejtje për kopje të planit që nuk na është shpërndarë, por është mirë që drejtori së paku përmes projektorit të pasqyroj dhe të shohim se ku gjendet parcela.

**Fatmir Iska –** Nuk është fjala për këtë kopje të planit por përfshin poseduese, ndërsa sa i përket listës së borxhlinjeve ne sa e morëm dhe unë e tërheqë propozimin tim për këtë pik të rendit të ditës le të jetë ashtu si është, ndërsa për Rregulloren për taksa dhe tarifa ne do të jemi kundër si pikë shtesë.

**Kryesuesi –** E qesë në votim rendin e ditës me pikat shtesë? Konstatoj që rendi i ditës është aprovuar me 20 vota pro, 7 kundër dhe 1 abstenim.

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.** A ka dikush vërejtje rrëth kësaj pike nëse jo e qes në votim. Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar procesverbal nga mbledhja e kaluar.

**2. Informimi mbi punën e stacionit Policor në Rahovec për vitin 2014,( informimin do të bëjë komandanti i Policor).**

**Osman Ismaili, Komandat i stacionit Policor në Rahovec –** Përvendetje për të gjithë të pranishmit prezantë. Edhe në KPF e kam paraqitë këtë raporte të punës për vitin 2014 e po ashtu edhe sot do ta paraqes.

Në emër të gjithë stacionit policorë në Rahovec dhe në emrin tim personal dua të ju falënderoj dhe ju përgëzojë për kontributin dhe angazhimin tuaj për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë gjatë vitit 2014, çështje kanë të bëjnë të gjitha me nivelin e sigurisë së qytetarëve të komunës sonë pastaj parandalimin dhe luftimin e çdo dukuria negative gjatë vitit të kaluar, pavarësisht praktikave të paraardhësve të mi është obligim ligjor i menagjmentit të këtij stacionon të jetë ma transparentë dhe të bashkëpunoj sa më ngushtë me ju të gjithë pa dallime, ne i referohemi obligimit ligjorë për informim të përhershëm kryetarit të komunës çdo ditë për të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet e policisë së Kosovës në komunën tonë, informacionet i japim në mënyrë elektronike çdo ditë por kemi edhe kontakte të shpeshta me kryetarin e komunës, kryetari i komunës një herri është edhe kryesues i këshillit komunal për siguri në bashkësi misioni i këtij forumi është të gjitha problemet dhe brengat e qytetarëve të komunës të cilat kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë dhe çështjet e tjera, për këto çështje ekzistojnë edhe 2 forume të tjera, Komiteti për siguri publike i cili përfshinë qytetin e Rahovecit dhe fshatin Hoçë e Madhe pra është multi etnike ku marrin pjesë edhe pjesëtarët e pakicave, përvèç kësaj është i formuar edhe një ekip veprues për Siguri në Bashkësi i cili vepron për tërë territorin e komunës së Rahovecit dhe janë të përfshira të gjitha strukturat e duke filluar prej udhëheqësve të fshatit, udhëheqësve politik, bizneseve, shkollat, OJQ, shoqëria civile etj. Stacioni policorë në Rahovec vepron si njësi organizative në kuadër të drejtorisë rajonale të polisë së Gjakovës prej 01.01.2015, ky kalim është bërë kon formë ligjt mbi kalimin e gjykatave të rregullta në Kosovë dhe kompetencës territoriale të gjykataës themelore në Gjakovë, stacioni policorë në Rahovec numëron gjithsej 73 punonjës prej tyre të uni formuar janë 59 dhe staf civil 14, bazuar në strukturën

Organizative të polisë së Kosovës dhe kategorizimin e këtij stacioni për momentin ky njësit funksionon me mungesë të madhe të stafit të uni formuar afér 30% është e paraparë me këtë strukturë të ketë ky stacion policorë deri në 87 punëtorë të uni formuar, përvèç mungesës së stafit ballafaqohemi edhe me mungesë të madhe

pajisjeve logistike, mungesë të automjeteve, të pajisjeve kompjuterike, pajisjeve forenzike si dhe pajisjeve tjera për kontrollin dhe kontrollimin rrugor. Objektivat e parapara për policinë e Kosovës janë kryesisht: Mbrojtja e rendit Kushtetues, Rendit dhe sigurisë publike në Kosovë, Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, Parandalimi ndjekja dhe zbulimi i krimit, Krimit të organizuar dhe korruptionit, Ngitja e nivelit të tolerancës dhe bashkëjetesës ndëretnike, Ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor, Parandalimi i incidenteve të tjera në shkolla etj, përveç implementimit dhe realizimit të këtyre objektivave ky stacion në bashkëpunim me institucionet e tjera komunale dhe ato të nivelit qendror eshtë i angazhuar edhe në luftimin e dukurive negative të cilat kanë të bëjnë më së tepërti me mbrojtjen e ambientit siç janë: Eksplantimi i egër i rërës dhe zhavorrit në shtratin e lumit Drin, degradimi dhe eksplantimi masovik i pyjeve, dëmtimet dhe vjedhjet permanente në trasenë hekurudhore Krushë e Madhe Mrasorë me gjatësi prej 30 km, hedha e mbeturinave vend e pa vend në të gjitha hyrjet e qytetit dhe vendbanimet tjera në komunën tonë të cilët paraqesin edhe rrezik permanent për sëmundjet e ndryshme, rrezik nga qentë endacak etj.

Rendi dhe Qetësia Publike - Gjatë vitit 2014 janë regjistruar gjithsej 40 raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike ndërsa në vitin paraprak 2013 kanë qenë 34 raste, pra një përqindje e vogël ka qenë në rritje, prishje masive të rendit dhe qetësisë nuk ka pas, konflikte ndëretnike masovike nuk ka pasur përveç rasteve individuale, eshtë mbajtur një protestë dhe dy tubime me karakter homazhi në shenjë të përkujtimit të vrasjes së deputetit Pista, duhet veçuar edhe mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të muajit qershor të cilët kanë qenë ndër zgjedhjet ma të qeta dhe më demokratike të pas luftës në Kosovë.

Kriminaliteti – Bazuar në statistikat vjetore të vitit 2014 sikurse në tërë territorin e republikës së Kosovës prinë për nga numri i veprave penale kundër pasurisë siç janë: Vjedhjet e rënda, vjedhjet dhe dëmtimi pronës, projektë sulmi i këtyre vjedhjeve janë kryesisht shtëpitë e pa banuara, Dyqanet, veturat dhe pajisjet tjera teknike, gjatë vitit 2014 janë raportuar gjithsej 596 raste ndërsa në vitin 2013 kanë qenë 648 këtu kemi një rrënje për 9 % ma pak, përqindja e zbulueshmërisë për vitin 2013 ka qenë 67% ndërsa në vitin 2014 ka qenë 75% pra edhe këtu kemi një rritje prej 18%, do ti prezantojë tash statistikat më të rënda të rasteve të veprave penale, në 2013 nuk kemi pas asnjë vrasje, ndërsa në 2014 kemi pas 2 vrasje, Lëndim të rëndë truporë në 2013 kemi pas 12 raste në 2014 vetëm 4 raste, Vjedhje në 2013 kanë qenë 77 ndërsa në 2014 78 raste, vjellje të rënda 83 2013 ndërsa në 2014 kanë qenë 85, grabitje në 2013 kanë qenë 5 ndërsa në 2014 kanë qen 1, incidentet ndëretnike nga minoriteti serbë janë raportuar gjithsej 6 raste, 3 raste të shkruarës së grafikëve dhe 3 raste dëmtimi pasurisë, prej këtyre rasteve 3 janë të zbuluara dhe 3 janë në procedurë të hetimit, dhunë në familje gjatë vitit 2013 janë raportuar gjithsej 18 raste ndërsa gjatë 2014 janë raportuar 15 raste, tek dhuna në familje kryesisht kemi të bëjmë me kërcënime, dhunë psikike, lëndime trupore etj, kryesisht viktima janë bashkëshortët dhe në shumicën e rasteve femrat dhe fëmijët dhe në shumë raste edhe anëtarët e tjerë të familjes si vëllezërit, motrat etj.

Incidentet në shkolla gjendja e sigurisë dhe e rendit në 41 shkolla në shkolla fillore dhe të mesme është e mirë dhe stabile edhe përkundër të disa incidenteve të izoluara, mësimin në këto shkolla e vijojnë gjithsej 12,856 nxënës, me qëllim të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe rendit në këto shkolla policia e Kosovës gjatë vitit 2014 ka implementuar shumë projekte në këto projekte janë përfshirë gjithsej 16 shkolla fillore në fshatra dhe qytet të cilat kryesisht gravitojnë në afersi të rrugëve rajonale dhe magjistrale dhe nëpër rrugë kryesore të qytetit, në ligjérata dhe punë praktike rregullimi i trafikut me nxënës janë përfshi rrith 2.350 nxënës nga klase e 1 deri në klasën e 9, demat që kanë dominuar kryesisht janë delikuencia e të miturve pastaj siguria e nxënësve në trafikun rrugor, parandalimi i dukurive tjera negative nëpër shkolla siç janë pirja e alkoolit, drogës dhe sjelljet e tjera devijonte, eshtë i domosdoshëm bashkëpunimi ma i mirë në mesë të prindërve, mësimdhënësve dhe institucioneve tjera relevante që në bashkëpunim me policinë e Kosovës ti risim këto aktivitete edhe me projekte të ndryshme duke i përfshirë mediat, shkollat, drejtorenë e arsimit, OJQ, shoqërinë civile dhe qendrën rinore.

Komunikacioni Rrugorë – Niveli i sigurisë i gjitha kategorive të rrugëve magjistrale, rajonale dhe rrugë lokale ka qenë e mirë, rrugët janë të ngarkuar kryesisht në sezonin veror gjatë muajit qershor dhe gushtë kjo është periudha e sezonit turistik dhe kthimit të bashkathtarëve në vendlindje për pushime verore, kemi një fluks të madh të automjeteve po ashtu edhe gjatë festave të fund vitit që edhe në këtë kohë kthehen po ashtu bashkathtarët tanë në vendlindje, pastaj ngarkesë në trafik kemi po ashtu gjatë procesit të mësimit në mëngjes kur nxënësit qarkullojnë dhe pastaj në mesditë dhe në mbrëmje, rrugët gjatë sezonit rrugorë kanë qenë të mirëmbajtura dhe të pastruara nga dëbora nga kompanitë përgjegjëse duku ka pasur vështirësi dhe ngecje për shkak të teknikës jo adekuate të cilën e disponojnë kompanitë mirëpo brenda 24 orëve është arritur çdo ku pavarësish terrenit dhe konfiguracionit që është i vështirë në disa fshatra e kemi Zatriqin, Koznikun dhe disa fshatra tjera mirëpo është arritur që qytetarët të qarkullojnë lirshëm brenda 24 orëve, gjendja e infrastrukturës rrugore në komunën tonë është e mirë por me disa dëmtime posaçërisht në rrugën rajonale Gradishë-Ratkovicë-Kramovikë dhe atje kemi më së tepërti aksidente ka mungesë të shenjave vertikale dhe horizontale në të gjitha rrugët mirëpo edhe në qytet shenjat vertikale çdoherë dëmtohen nga personat të pandërgjegjshëm e në disa raste edhe i vjedhin.

Aksidentet e trafikut – Gjatë vitit 2014 kanë ndodhur gjithsej 273 aksidente, aksidente fatale me të vdekur 3, me lëndime të rënda 25 raste të lënduar 37 persona, me lëndime të lehta 75 raste të lënduar 89 persona, si dhe më dëme materiale 170 raste, ndërsa shkaqet kryesore të aksidenteve janë tejkalimi i shpejtësisë, mospërshtatja e kushteve të rrugës, alkooli, infrastruktura e dëmtuar e rrugëve, pjesëmarrja e madhe e makinave të punës traktorëve, ekskavatorëve në rrugë pa drita në orët e mbrëmjes, po ashtu kemi të bëjmë edhe me nivelin e ulët të edukimit dhe vetëdije së pjesës ma të madhe të pjesëmarrësve në trafik pa marrë parasysh se a janë në cilësinë e këmbësorëve apo të shoferëve. Gjobat e lëshuar gjatë vitit 2013-2014, gjatë vitit 2013 ky stacion policorë ka shqiptuar 3.190 gjoba ndërsa në vitin 2014 janë shqiptuar 5.500 gjoba pra 72 % kemi pas rritje, kjo është bërë mu për shkak të pasojave në tërë Kosovën ka qenë numri i të vdekurve vitin e kaluar 122 i të vdekurve në trafik 4.000-5.000 i të lënduarve rëndë dhe letë ndërsa për aksidente për dëme materiale mos të flasim, me aplikimin e masës së konfiskimit të dokumenteve patentë shoferëve dhe të lejeve të qarkullimit në periudhën e vitit 2014 e deri me 31 janar 2015 janë paguar në afat rekord 2.700 gjoba vetëm këtij stacioni, kjo shifër është edhe ma e madhe kur të llogarisim edhe trafikun rajonal i cili 2-3 herë ma shumë ka lëshuar gjoba në territorin e komunës sonë, ky stacion ka qenë mjaftë efikase në realizimin e pagesave të gjobave të cilat kanë kontribuar drejtëpërdrejtë në të hyrat e buxhetit komunal, bazuar në statistikat e drejtorisë për financa gjendja e të hyrave është si vijon: Në vitin 2013 gjoba në trafik që janë paguar brenda 15 dite kanë qenë 23.706 €, gjobat që kanë ardhur nga gjykata 90% janë nga dënimet e stacionit policorë kanë qenë 37.321 € pra gjithsej 61.027.00 €, ndërsa në vitin 2014 kjo rritje është bërë 3 herë ma shumë për shkak të konfiskimit të dokumenteve, gjobat në trafik, në këtë vit të hyrat kanë qenë 102.962.00 €, ndërsa gjobat që kanë ardhur nëpërmjet gjykatave kanë qenë 137,212.00 € dhe totali 241,074.00 € këto të

hyra shkojnë për investime kapitale në Komunën e Rahovecit, me vendimin e ministrit të brendshëm i nxjerrë në shkurtë të këtij viti këto të hyra dhe këto mjete buxhetore do të zgjedhën 3-4 herë në këtë vit, i vetmi fat është nëse projektit do të aprovohet në parlamentin e Kosovës dhe ata do ta zgjidhin mënyrën apo procedurën se si do të ekzekutohen këto dënlime, sepse kjo ndikon drejtërsëdrejtë në vjetërsimin e lëndëve kështu që diku afër 50 % të lëndëve nëpër gjykatat tona vjetërsohen, gjatë vitit 2014 janë realizuar 1.700 urdhëresa të lëshuara nga gjykatat dhe prokuroritë e shtetit, persona të atestuar kanë qenë gjithsej 237 të ndaluar në qeli kanë qenë 37 persona. Lëshime të dokumenteve – Vërtetime për dokumente të humbura janë lëshuar 720, vërtetime për të kaluarën kriminale janë lëshuar 907, vërtetime për paraqitje të vendbanimit 567. Aktivitetet Operative – Asistimet e gjykatave, Kedsit, Kuvendit të komunës, AKP, ATK, kompanisë radoniqi dhe përbartuesve privatë kanë qenë 42. Armët dhe municionet e Konfiskuara – Armë të shkurtë dhe të gjata 21, municione 238. Shpenzimet në stacionin policorë – Gjithsej me automjete zyrtare janë kaluar 22,282.00 km pra këto km janë kaluar nga 3 ose 4 vetura sepse ma tepër nuk kemi, derivate të harxhuara për automjete naftë 24.280 Litra, Rrymë 4.872 €, Ujë 447 €, mbeturina 542 €, telefon fiks 1.152 € duke i përfshirë 45 telefona, naftë për gjenerator janë harxhuar 577 litra dhe diku afër 700 €, po ashtu për nxehje qendrore kemi diku afër 12.000 litra naftë dhe 4.500 € pilet,

**Migrimi Ilegal – Policia e Kosovës** është në implementimin e projektit qëndro në vendin tuaj i cili projekt ka të bëjë me masat dhe aktivitetet që ka marrë policia e komunitetit në bashkëpunim me institucionet e tjera me qëllim të parandalimit të migrimit ilegal masovik nga Kosova për në shtetet e BE-së, me një largim masovikë posaçërisht gjatë 2-3 muajve të fundit të vitit të kaluar ka vazhduar edhe në janar-shkurtë të këtij viti, në komunën e Rahovecit për në shtetet e BE-së bazuar në disa statistika të pa sakta janë larguar disa qindra qytetarë dhe më së tepërm kemi raste individuale kryesish të rijnë por ka edhe ma familje dhe grupe, sipas statistikave zyrtare të drejtorisë së arsimit në komunën tonë kanë lënë mësimin në shkollat filllore dhe të mesme gjithsej 72 nxënës, tani për momentin ky fluks ilegal ka rrënje në minimum për shkak se shtetet e BE-së nuk pranojnë statusin e azilit politik e as ekonomikë, pastaj është forcuar kontrolli i kufirit Serbi-Hungari me angazhimin e policisë të shteteve evropiane në veçanti nga Gjermania, Austria dhe shtetet e tjera të cilat janë në mbështetje të policisë Hungareze dhe serbe. Disiplina – Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 8 raste të shkeljes disiplinore nga zyrtaret policorë, prej tyre 4 kanë të bëjnë me ankesa të qytetarëve prej të cilëve nga komisioni disiplinorë 3 janë konstatuar si të pa bazuara ndërsa 1 është në procedurë e sipër dhe 4 rastet e tjera janë 2 shkelje të rënda dhe 2 të lehta në 4 rastet zyrtarët policorë janë dënuar dhe ju kanë shqiptuar dënimet. Të nderuar të pranishëm ju ftoj për një bashkëpunim më të ngushtë me policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante posaçërisht me ato që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë që qytetarëve tanë ti sigurojmë një ambient të qetë dhe të sigurt duke u angazhuar në parandalimin e çdo dukurie negative në shoqerinë tonë.

Pagat ne i kemi të kategorizuara në bazë të gradave, paga ma e madhe është 599.00 € e Kapitenit të stacionit, Togerëve është diku afër 500 €, 350 € deri në 400 € është e rreshterëve dhe e policëve, ndërsa paga ma e ulët është 270 € është e pastruesit. Të nderuar të pranishëm unë ju ftoj që të gjithë asamblistët të na viziton sepse ne kemi kohë për ju dhe që të njoftoheni më për së afërm me punën tonë që jemi duke e bërë, ne do të jemi transparent në bashkëpunim me juve dhe çdo ardhje e juaj është e mirëseardhur.

**Sinan Bajraktari – Pyetje për Komandantin**, ne e dimë që në fund të vitit 2014 janë bërë disa vjedhje në komunën tonë, në mesin e këtyre vjedhjeve dhe thyerjeve është edhe lokal im Minimarket “Xeli” në Polluzhë. Deri ku ka arritur zbardhja e këtyre krimeve në komunën tonë.

**Selim Duraku – E falënderoj komandantin për këtë prezantim.** Dua të ndalem në 3 pikat kryesore të sigurisë, për qentë endacak, vjedhja e shtëpive dhe siguria nëpër shkolla. Për qentë endacak kemi biseduar shumë herë por nuk është arritur asnjëherë ndonjë rezultat. Ndërsa sipas raportit vjedhje të shtëpive ka pasur diku rrëth 150 raste të vjedhjeve të lehta dhe të rënda. Ndërsa sa i përket sigurisë nëpër shkolla, në kohën e fundit ka pasur shumë rrahje dhe janë përdorur edhe armë të ftohta dhe armë zjarri. Çfarë masa parandaluese keni mare për këto 3 çështje.

**Mirjeta Krasniqi – Jam e shqetësuar për sigurinë e nxënësve, ku disa shkolla si në Rahovec, Xërxe, Postasel dhe disa të tjera, nxënësit rrezikohen në kalimin e rrugës kurë hynë dhe kur dalin nga shkolla. Po ashtu edhe tek çerdhja “Tulipanët” nuk ka rrëthojë në njérën anë të urës të lumit “Duhllo” dhe fëmijët mundë të kenë qasje drektë me lumin. Po ashtu gjatë lumit janë hequr kapakët e pusetave ku rrezikohen kalimtarët, çka mund të bëni për t'i tejkular këtë probleme.**

**Kryesuesi – Dua të ju përkujtoj se komandanti nuk mirët me këtë çështje, ju mundë të bëni pyetje vetëm rrëth çështjes së sigurisë, ndërsa për këto pyetje e keni drejtorin për shërbime publike.**

**Kadri Dellova – Më vije mirë që komandantin e kemi këtu sot dhe paraqet rendin dhe qetësinë në komunën tonë, po ashtu falënderojmë Stacionin policor në Rahovec që ka pas një bashkëpunim shumë të mirë si me qytetin ashtu edhe me fshatra. Unë si përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve do t'i ngriti disa shqetësimë dhe disa pyetje. E para: rruga rajonale Rahovec-Krushë ka shumë kthesa dhe paraqet rrezik të madh dhe në këtë rrugë nuk ka shenja vertikale e as horizontale dhe ka pasur shumë raste tragjike në këtë rrugë për shkak mos ekzistimit të shenjave paralajmëruese. Po ashtu ka qenë një kërkësë e shkollës “Ukshin Hoti” në hyrje të fshatit që të vihen policiet e shtrirë. E njëjtë kërkësë ka qenë edhe e shkollës filllore “Heronjtë e Kosovës” në Hoqë të Vogël. Është kërkësë e qytetarëve që gjatë sezonës së verës në rrugën magjistrale Prizren- Gjakovë të vendosen shenjat e lëvizjes së teknikave bujqësore. Në Krushë të Madhe 2-3 vitet e fundit kanë ndodhur disa vjedhje të rënda. Janë vjedhur disa automjete të disa familjeve të cilat kanë qenë jetike për ato familje se pse me ato mjete e kanë mbajtur mbijetesën e tyre dhe deri më tani nuk është bërë asgjë për zbardhjen e këtyre vjedhjeve. Deri ku ka shkuar zbardhja e vrasjes së Nënkyetarit të PDK- së ish kandidatit për deputet z.Elvis Pista. Dhe pyetja e fundit, edhe ju ishit prezentë në këto ditë të fundit në shumë tubime përkujtimore në Krushë të Madhe, Celinë, Brestovc, Bellacërkë, dua ta di se sa është bërë në kapjen e kriminelëve serb.**

**Florije Boshnjaku – Pyetja e parë është si është bashkëpunimi i policisë në Rahovec me QKMF-të dhe sa ata i njoftojnë me rastet që kanë të bëjnë me dhunë dhe format e ndryshme. Pyetja e dytë është në lidhje me gjobat në trafik, sipas raportit që na ka dorëzuar kryetari i komunës për vitin 2013 janë 23,706.00 € ndërsa për vitin 2014 janë mbi 102,000.00 €, ndërsa sipas informatës që e dëgjova nga komandanti i policisë në vitin 2013 janë shqiptuar diku 3.900 dënlime, ndërsa në vitin 2014 ka pasur 5.500 dënlime a është shtuar kjo shumë sepse tash kemi një shumë marramendëse nëse marrim dënimet që janë shqiptuar.**

**Ejup Kabashi – Unë e përcolla me vëmendje raportimin e komandantit për punën bërë dhe pash që komandanti pati disa vërejtje e veta të arsyeshme në mungesë të stafit dhe kjo është shqetësuese, por nga të gjitha këto që dëgjova pash që ende ka shqetësimë për vjedhje, grabitje dhe gjitha këto raporte që dalin nga komandanti janë të raportuara nga familjarët. Kam një pyetje çfarë është fati i 2 stacioneve**

që kanë funksionuar në fshatrat Ratkovc dhe Xërxe dhe a do të ketë mundësi të ngritën këto dy pika për sigurinë e komuniteteve që jetojnë në këto pjesë.

**Rasim Fazliu** – Falënderoj komandantin e stacionit policor në Rahovec që për herë të parë na ka dhanë një informatë rrithë sigurisë në Komunën e Rahovecit. Kam disa pyetje. Pyetja e parë është sa është përqindja e zbulimit të krimtit të kryesve të veprave penale nga fushë veprimi i stacionit policor në Rahovec. Pyetja e dytë, çfarë bashkëpunimi ekziston mes stacionit policor dhe gjykatave. Pyetja tjetër, sa jeni të informuar për dukuritë devijante në përgjithësi që ndodhin nëpër shkolla.

**Lirih Berisha** – Është mandati i dytë që jam asambleist dhe është hera e parë që një komandant i policisë na jep informatë për gjendjen e komunës. Unë kam vetëm një kërkesë dhe kisha lutë komandantin që patrullat e policisë të dërgojë më shpesh edhe nëpër periferi dhe në fshatra, sepse kemi fëmijët e rinjë që vozisin makinat pa leje dhe shkaktojnë një rrezikshmëri në komunikacion.

**Arsim Kastrati** – Komandanti tha që në vitin 2013 gjobat në trafik kanë arritur deri në 60.000 € ndërsa në vitin 2014 deri në 200.000 € dhe dua ta di se a ka ndodhur pikërisht në muajin maj ku janë dënuar mbi 300 nxënës, dhe sa është produktive kjo, a ka ndikuar mirë, po ashtu dua ta di se sa kanë qenë veprat penale të mashtimit në 2014.

**Besnik Hoti** – Zona e anadrinisë është një zonë e banuar me numër të lartë të popullsisë dhe ka nevojë emergjente për vendosjen e një nënstacioni policor në fshatin Ratkoc, me qëllim të ofrimit të një sigurie më të lartë për atë zonë, ku dihet në të kaluarën dhe tash kemi pas raste të vjedhjeve dhje veprave tjera penale. Kërkoj nga komandanti që të merr hapa për vendosjen e këtij nën stacioni policor. Po ashtu kam edhe një shqetësim tjetër të qytetarëve, a jeni në dijeni se në tregjet e komunës sonë hapur shiten mjetet e ndaluara siç janë thika, boksi i hekurt, shkopinj gome etj., dhe si pasoj e këtyre mjeteve kemi rrahje të nxënësve nëpër shkolla.

**Luljeta Kadiri** – Kam një pyetje për komandantin me rastin e bartjes së Rahovecit në regjionin e Gjakovës dhe e shohim një frekuentim mjaftë të shtuar të policëve regional. Më intereson gjobat që caktohen nga ky grup i policëve në cilin buxhet derdhen. Po ashtu kam edhe një sugjerim ose këshill që shërbimi mjekësorë i QKMF-së kanë një kontakte numër me juve 038 për të qenë ai kontakt falës me ju ne duhet të kontaktojmë përmes Gjakovës. Kishim dashtë që të kemi një numër dhe të jetë falas për bisedë me stacionin të Rahovecit që në raste nevoje të kontaktojmë direkt me juve.

**Fatmir Iska** – Po krijohet një praktikë e mirë e raportimit të stacionit policor para Kuvendit komunal edhe pse e dimë se këto tema po shtjellohen në KKSB. Njëkohësisht e urojë komandantin për pozitën e re. Unë e kam një pyetje, sa është mbulueshmëria e patrullimeve në komunë, duke ditur se kemi një numër të vogël të stafit policor, dhe tjetra desha ta përgëzojë për trajnimin që e ka organizuar policia nëpër shkolla këtu në Rahovec me fushatën përvetëdijësimin dhe pajisjen e nxënësve me shenja identifikuase kur të dalin në rrugë.

**Rexhep Oruci** – Komandanti e dha një raport të tërësishëm të punës për vitin 2014, është një gjë e mirë dhe duhet të praktikohet edhe në të ardhmen. Unë kam një koment dhe një propozim që të shtohet patrullimi tek rruga në shkollën e mesme të gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni”, sidomos në kohën kur bëhet ndërrimi i pas ditës, sepse në këtë kohë lëvizin shumë automjete dhe shumica janë pa patentë shofer. Ndërsa komenti që komandanti gjatë raportimit përmendi vendimin e ministrit për shfuqizimin e vendimit përkufizimin e patentë shoferit dhe dokumentacionet tjera. Mendoj se është vendimi politik i nivelit qeveritar dhe se është një vendim i arsyeshëm dhe shumë ekspertë e kanë konstatuar se vendimi përmarrjen e dokumentacionit është antikushtetues dhe duhet të ikim nga këto komente pasi ne jemi një njësi shumë e vogël dhe po ashtu edhe një region shumë i vogël.

**Afrim Limani** – Falënderoj komandantin për raportin, kam një pyetje në numrin e rasteve të vjedhjeve të rënda dhe të lehta sa ka mundur policia jonë ti identifikoj këto raste.

**Osman Ismaili** – Këto janë të gjitha brengat dhe shqetësimet që ju shqetësojnë juve edhe neve e në veçanti qytetarët tonë. Sinan Bajraktari pyeti për vjedhjet ne vetëm në vitin e kaluar. Ka afér 10 grupe kriminale që kanë vepruar në tërë terë territorin tonë, por përfat të keq vetëm kur ato ndodhin mediat bëjnë lajm. I kam dërguar disa herë mediave në Prishtinë dhe nuk i kanë botuar. Ka 12 apo 13 raste të vjedhjeve të zbuluara, ndërsa rastet në vitin e kaluar janë zbuluar afér 75 % pra është një rritje prej 15 % në krahasim me vitin 2013 dhe kryesisht janë rastet e vjedhjeve të rënda dhe të lehta. Veprat penale që janë kryer në vitet e mëparshme nuk vjetësohen dhe është çështje kohe se kur do të përfundojnë, do i vije dita edhe atij grupi që atje operon. Selim Duraku pyeti për qentë endacak. Kam shpjeguar edhe herën e kaluar, kjo është një brengë serioze në tërë Kosovën. Kemi pas një rast, një lëndim të lehte në Xërxe dhe kemi pas shumë ankesa nga qytetarët. Ne kemi bërë disa likuidime të qenve së bashku me shoqatën e gujetareve aty ku janë të rrezikshme dhe me sëmundje. Sa i përket likuidimit masovik është një ligj që na ndalon t' i ekzekutojmë. Ne kemi një qendër të rehabilitimit të qenve në Nagavc, por ajo është e varur prej OJQ-ve e jo nga pushteti lokal dhe trajtimi i një qeni në këtë qendër është 40-70 € dhe ju e dini se sa keni mundësi me nda buxhetin për këtë çështje. Sa i përket vjedhjeve të shtëpive është e vërtet që këto vjedhje bëhen kryesisht në ato shtëpi që nuk janë të banuara dhe tek vjedhjet tjera të shtëpive dhe banesave. Kryesisht kemi të bëjmë afér 50% vjedhje brenda familjarëve, posaçërisht ari dhe valutat kur janë në pyetje dhe e thashë se zbulueshmëria është 75%. Sa i përket sigurisë në trafik unë i ceka ma lartë ato terminët ditore që i kemi. Kemi 4 shkolla të mesme dhe ne mundohemi ti mbulojmë me patrulla posaçërisht kur bëhet ndërrimi gjatë ditës sepse numri i nxënësve është i dyfishuar edhe ata që lirohen edhe ata që shkojnë për t' ja filluar mësimin. Sigurimi nëpër shkolla duhet të jemi shumë të kujdesshëm tek përdorimi i termëve nëpër shkolla, shpesh herë mediat thonë huliganizëm, dhunë, krime nëpër shkolla dhe ne duhet sa ma larg këtyre termëve të qëndrojmë, sepse ata janë fëmijë tanë janë ardhmëria jonë, ata që fëmijët i bëjnë janë sjelljet delikuente pastaj vije pirja e duhanit, pirja e alkoolit, ka pak dhe shumë pak pirja e drogës, pra jemi ndër komunat që përdorin më së paku drogën. Mirjeta Krasniqi pyeti për shkollat dhe për lumin “Duhillo” dhe kapakët që nuk janë në vende. Është e vërtet se janë vjedh disa herë dhe është e vërtet se i kanë vjedh të gjitha poqët dhe i kanë thyer, por kush i bënë këtë, e bëjnë fëmijët tanë. Sa i përket lumit nuk paraqet rrezik për nxënësit, sepse është shumë e cekët, sa i përket mbrojtësve anësorë është çështje e investimeve buxhetore. Kadri Dellova pyeti për rrugën rajonale Rahovec Krushe e Madhe. Vërtet është pa mbikëqyrje, ne kemi mjaftë probleme me ato kompani që i mirëmbajnë edhe gjatë dimrit por edhe verës, ajo është nën mbikëqyrjen e ministrisë përkatësish drejtorisë së rrugëve. Ne bëjmë rregullisht kërkesa, mirëpo investimet janë shumë të vogla. Sa i përket policëve të shtrirë të vendosen nëpër shkolla duhet investime sepse një policë i shtrirë kushton diku 600-700 €, përndryshe ka qenë mirë të vendosen në gjithë komunën e Rahovecit aty ku është e nevojshme. Vjedhjet e automjeteve për të qenë ma mirë i informuar z. Dellova ejani dhe shikoni se cilat automjete dhe traktorë janë zbuluar dhe ju kanë kthyer pronarëve. Çështja ma e ndjeshme për vitin e kaluar është zbardhja e rastit të vrasjes së kandidatit për deputet z. Elvis Pista, nuk e di a e keni dëgjuar informatën e fundit që e ka dhanë

kryeprokurorja se janë të intervistuar mbi 100 persona si dëshmitar. Pista e zbulimit nuk kanë shkuar në rrjedhë të mirë dhe është përgjegjësi e njësitet qendror i cili merret me vrasjet, por vetëm e di se ende nuk ka asnjë të dyshuar dhe nuk është arrestuar askush për këtë rast, edhe pse është nën përgjegjësinë e atij njësiti ne normalisht e kemi dhanë kontributin tonë dhe prapë do ta japid, me ndihmën e juaj me informacionet e juaja dhe ju kisha lutar edhe juve edhe qytetarët secili që e ka ndonjë informacion më të vogël mundet me na përcjellë lirisht dhe do të mbeteni anonim. Po ashtu edhe pyetje tjetër që ishte nga z Dellova zbulimi i krimeve të luftës, ne krejt çka është dashur para 16 viteve i kemi afruar UNMIK-ut dhe policisë të EULEX dhe njësive tona qendrore. Problemi ma i madh qëndron se ata janë 6 muaj ose 1 vit ne mision dhe vjen tjetri mirët me Gjilanin, me Pejen dhe nuk merret me Krushen, Pastaselin, Fortesën etj dhe rezultati nuk është i kënaqshëm, por prapë se prapë dëshmitë ekzistonë sepse njerëzit janë gjallë që kanë qenë pjesëmarrës në ato masakra. Florije Boshnjaku pyeti se si është bashkëpunimi me QKMF? Ne kemi një bashkëpunim të mirë me QKMF, për raste që kanë lëndim, dhunë në familje, vdekje të dyshimtë, ata na raportojnë sepse ligji ja obligon dhe ne jemi menjëherë aty. Pastaj angazhimi i tyre është edhe nëpër tubime dhe rreziqe tjera, si vërvshimet, zjarret, tërmëte sëmundje etj., edhe pse ata kanë shumë pak teknik dhe shumë pak ekipe për terren dhe bashkëpunimi është shumë i mirë. Të hyrat në buxhetin nga gjobat në trafik, unë e kam reportin e drejtorisë së financave, e thash ma herët se ato janë 4-5 herë më të mëdha duke i falenderuar konfiskimit të dokumenteve, unë nuk e pata me qëllim që ta kritikoj Ministrin as që dua të merrem me te sepse ai i ka përgjegjësit e veta dhe ne tonat, mirëpo desha të tregoj se niveli tek pagesat e gjobave është zero tek ne dhe për dy vite vjetësorhet. Prej gjobave shkojnë 240.000 € në buxhetin e komunës dhe këto mjete mund të përdoren vetëm për investime kapitale. Ejup Kabashi kishte pyetje për vjedhjet dhe për nënstacionet në Ratkoc dhe Xërxë. Sa i përket vjedhjeve Ejup ju mundë të vini vet në polici dhe të shihni se cilat vjedhje janë zbuluar e cilat jo. Plagosje që ka qenë vitin e kaluar e atij qytetari nga automatiku që ka qitë një person në dasmë pas një viti është zbuluar. Ju në fshatin tuaj në Apterushë nuk keni shumë vjedhje. Sa i përket fatit të nënstacioneve në fshatin Xërxë dhe Ratkoc, ju e dini se gjatë luftës kanë funksionuar këta dy nënstacione të cilat janë shuar pas lufte. Në Ratkovic ka funksionuar 1 vite e gjysme pas lufte, pastaj edhe aty është mbyllur nga ana e UNMIK-ut për shkak të kushteve jo të mira dhe mbyllja është bërë pa dëshirën tonë. Unë kam bërë një kërkesë para 6 viteve që të hapet ai nënstacion por është dashur diku rreth 44.000 € që të rinovalohet ai objekt, por për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore edhe në nivel të Ministrisë së Brendshme dhe nivel komunal ka mbetur ende pa u hapur. Në fshatin Xërxë nuk parashohim të hapim nënstacion sepse është afër me qytetin, por vetëm në fshatin Ratkoc. Sa i përket Hoçës së Madhe ne e kemi një zyre atje të cilën e përdorim vetëm për minoritete serbe dhe ajo punon vetëm prej rastit në rast. Po ashtu në mungesë të stafit edhe atje nuk po mundemi me hapë 24 orë atë zyre. Rasim Fazliu pyeti për zbulueshmërinë e veprave penale dhe për bashkëpunimin me gjykatat. Përqindja e zbulueshmërisë e thashë më herët është 75% dhe kryesisht vjedhjet janë me kryes tē panjohur. Bashkëpunimi mes gjykatave dhe stacionit policor, kishte me qenë mirë që të niseni prej vvetves dhe të shikoni se çfarë bashkëpunimi keni ju me ta dhe besoj se e keni një përgjigje të quartë. Me Ligjin mbi prokurorinë e shtetit dhe me Ligjin e procedurës penale, prokurori publik menaxhon me policinë hetimore, pra jemi dy organe ndjekëse, e treta është gjykata. Bashkëpunimi nuk mungon, por kryesisht merremi me shoqërimë dhe ekzekutime. Pra 1700 urdhëresa vetëm të prokurorisë dhe të gjykatave janë zbatuar dhe ekzekutuar. Sa i përket anës tjetër se sa janë ata azhure, përfat tē keq aty janë 400.000 raste nëpër gjykata që sillen nëpër arkiva të gjykatave kryesisht lëndë civile dhe për kundërvajtje ndërsa ato penale kanë prioritet. Rasimi e ka përdorur termin adekuat dukuri devijante nëpër shkolla e jo huliganizëm, sepse ne nuk guxojmë të përdorim këtë term. Besniku pyeti për shitjen e boksave të hekurt dhe thikave nëpër tregje të hapura. Me ligj parashihet që nuk guxon me qenë ma i gjatë tehu i thikës se 8cm dhe ato që janë me tē gjata lirisht mundet inspektorati t' i konfiskoj. Ne bëjmë edhe bastisje kohë pas kohe nëpër autobusë që dyshojmë edhe nëpër klasa nëse ka dikush ndonjë mjet të rrezikshëm, por së pari duhet tē shteren të gjitha mjetet demokratike pedagogjike të shkollës. Sa i përket përdorimit të drogës nga nxënësit janë raste shumë të ralla që mund tē numërohen me gishta dhe nuk duhet tē zmadhohen ato sepse nuk ka nevojë. Lirih Berisha kishte një shqetësim që patullat tē jenë prezantë ma shumë nëpër fshatra, për shkak të vozitjes pa leje tē fëmijëve, Po e them edhe një herë 73% janë dënimet ma së shumti, si në qytet ashtu edhe në fshatra mu tē kësaj kategorie, por mos tē harrojmë se ne në këtë moment i kemi në dispozicion vetëm dy patrulla dhe mbulojmë 24 orë tërë territorin e komunës, kurse natën është vetëm një dhe ajo duhet në çdo fshat tē shkojë patjetër. Arsim Kastrati pyet për dënimin e nxënësve. Nuk ka dënim tē nxënësve, ka vetëm masa edukative, nëpër gjykata ka dënim e në shkolla nuk ka. Sa i përket gjobitës së maturantëve ne vitin e kaluar e kemi paralajmëruar edhe drejtoren e arsimit edhe drejtoret e shkollave nuk ka ngasje tē veturave për natën e maturës nga nxënësit sepse ata pinë alkool. Ne i kemi pas 2-3 raste tē rënda që kanë pësuar nxënësit edhe deri me vdekje, për atë duhet drejtoret tē organizojnë autobusë që t'i dërgojnë dhe ti kthejnë mbrapa sa ma sigurtë. Kanë qenë diku afër 13-15 maturantë vitin e kaluar tē dënuar në Xërxë që kanë qenë pa leje dhe nën ndikim të alkoolit dhe ne nuk tolerojmë këtë por as ju nuk duhet tē toleroni si pushtet lokal. Luljeta Kadiri pyeti për kalimin e stacionit policorë i Rahovecit nën Gjakovë. Kjo është çështje ligjore e cila rregullon kompetencën e gjykatave themelore dhe neve nuk na ka pyetur askush, por besoj se as juve nuk ju kanë pyetur se a dëshirojmë tē shkojmë me Gjakovën. Komuna e Rahovecit nuk ka kurrfarë varshërie me komunën e Gjakovës, ne jemi tē pavarur i kemi organet e pushtetit lokal dhe nuk i japid llogari askujt tjetër përpos organeve tē komunës sonë. Sa i përket çështjes së telefonit pa pagesë është në vala 192, përsëj jugore tē komunës sonë paraqitet qendra operative e Prizrenit ata nuk prezantohen por vetëm thonë policia mjafton që ju tē i thoni më lidhni me stacionin policorë në Rahovec dhe kuqet lidhja për 3 sekonda, përsëj veriperëndimore paraqitet Gjakova e njëjta procedurë vlen edhe për ata. Fatmir Iska faleminderit për urimet, ne gjatë vitit që shkojë polici i komunitetit ka shpërndarë nëpër shkolla nxënësve disa shenja reflektuese tē cilat nxënësit mirë është që t'i vendosin në çanta, sepse ato reflektojnë deri në 200-300 metra. Rexhep Oruci unë bisedova mjaftë rrëth kapacitetit njerëzorë që e kemi sepse po tē kisha stafe do i qitja 5 patrulla në teren. Ne ma shumë merremi me rastet kur kërkojnë ndihmë qytetarët se sa me patrullime. Rreth 70% tē këtyre gjobave janë tē lëshuar në Rahovec në qytet, dhe mundë tē shihen në kompjuter se sa janë lëshuar para shkollave. Sa i përket konfiskimit të dokumenteve ne i tolerojmë në rastet kur janë për spital këtu ose jashtë shtetit të Kosovës, ne i kemi ik këtyre rasteve dhe kemi hasë në mirëkuptim, mirëpo ka qenë vendim dhe ne është dashtë tē zbatojmë dhe prej asaj dite që është ardhur vendimi që mos tē mirën dokumentet ne nuk i marrim e zbatojmë vendimin e ri, dhe mundë tē vinë tи marrin edhe ata që i kemi marr më herët. Afrim Limani pyeti për zbulueshmërinë e veprave penale unë e ceka mëa lartë se është 75%. Ju falënderoj tē gjithëve për vëmendje dhe për pyetjet e bëra.

**Kryesuesi – Falënderojmë komandantin për përgjigjet e dhëna dhe për bashkëpunimin që ka pasur për informimin e këshilltarëve tē Kuvendit komunal për reportin e punës 1 vjeçare tē stacionit policor gjatë vitit 2014.**

**Isak Hoti**, udhëheqës i zyrës ligjore – Zyra ligjore e ka hartuar Rregulloren për organizim të brendshëm përgjegjësit e administratës së komunës së Rahovecit. Kjo rregullore është vonuar për shkak të një vendimi të qeverisë së Kosovës të datës 5.02.2015 pastaj është përcjellë me një qarkore të cilën i ka obliguar komunat që të bëjë standardizimin e tituve dhe pëershkrimin e vendeve të punës dhe kjo deri me 17.04.2015 të dërgohet në MAPL, përvèç kësaj është e obliguar edhe Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, ne në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me Rregulloren për organizimin e brendshëm sepse Rregullorja për sistematizimin punës do të pësojë me një rregullore të veçantë. Rregullorja gjithsej i ka 32 nene ku përfshihen edhe dispozitat kalimtare, bazën e ka tek neni 14 pika 2 shkronja C e LVL dhe neni 34 pika 1 e Ligjit për Administratë Shtetërore 03/189. Pra vonesa është bërë sepse ne është dashur që ta harmanizojmë rregulloren me katalog sepse në katalogun e ri nuk parashihen më zyre por vetëm sektorë dhe njësi, kjo rregullore ka ardhur pas plotësim ndryshimit të Statutit të komunës gjegjësisht tek neni 6.

**Kryesuesi** – Siç e dini edhe ju me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit që janë bërë përgjegjësitet, kompetencat dhe detyrat e drejtorive i kemi hequr nga Statuti, sepse këto kemi thënë që do të rregullohen me një rregullore të veçantë dhe tani kjo rregullore është këtu para neve dhe besoj se është në harmoni me udhëzimet administrative dhe LVL.

**Florije Boshnjaku** – Që në mbledhjen e kaluar kur e kemi pas këtë rregullore unë i kam dhanë vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet të cilat nuk janë pajtuar me këtë rregullore edhe sot po i shprehi shqetësimet e mia se katalogu për vendet e punës si na ka njoftuar drejtori i Departamentit të Administratës Publike prej 8.000 vendeve të punës dhe tituj është ardhur në 800 tituj, ne nuk mundemi me e pranua këtë rregullore pa u harmonizuar kjo rregullore me katalogun e punës. Ne nuk jemi kundër rregullores por nuk jemi për atë që kjo rregullore të dorëzohet në MAPL dhe të kthehet prapë. Kryesuesi i Kuvendit e tha se kur e kemi ndryshuar statutin përgjegjësitet i kemi lënë kryetarit të komunës, por unë e them se prapë kjo rregullore nuk është në përpunë me aktet që janë në fuqi. Tek neni 5 thotë se me punën e drejtorisë udhëheq drejtori, me punën e sektorit udhëheq shefi i sektorit, me punën e njësisë udhëheq shefi i njësisë, me punën e zyrës udhëheq shefi i zyrës, ndërsa sipas trajnimit që kemi pasur kjo është në kundërshtim me atë katalog.

**Fatmir Iska** - Rregulloren me plotësimi nuk e kemi lexuar dhe nuk kemi mundur të lexojmë sepse nuk kemi pas kohe, tani e kemi si pikë të rendit të ditës. Gjatë shqyrtimit për ndryshimin e Statutit ne kemi qenë kundër pikërisht për mos me i lejuar kryetarit këto kompetencia lidhur me organizimin e drejtorive brenda komunës. Ne vazhdojmë të jemi kundër asaj dhe kundër kësaj rregullore, pra vota jonë do të jetë kundër kësaj rregullore dhe çdo rregullore që do të servohet në këtë mënyrë.

**Kryesuesi** – Unë nuk e di se ku është duke shkuar se kjo është kompetencë e kryetarit, dhe pyes se kush është duke aprovuar këtë kryetari apo Kuvendi.

**Bahtjar Hoti** – Nëse ka mundësi ato vërejtje që i ka grapi i AAK të del me i specifiku në mënyrë që ta dimë se për çka bëhet fjalë dhe për cilën pikë, ndërsa diskutimi që po bëhet po bëhet në të mirë të komunës, sepse unë e kam të pa qartë se çka duhet të votoj e çka nuk duhet, pra të mos kemi kritika pa argument por të kemi të specifikuar.

**Kryesuesi** – Këta problemi e kanë se për shkak se me ndryshimet në statut organizimi i brendshëm i administratës bëhet me një rregullore të veçantë, si dhe rritja dhe zgjedhimi i numrit të drejtorive bëhet me vendim të kryetarit të komunës. Unë kam qenë në Ministri, jam konsultuar dhe ata më kanë thanë se kjo nuk është ndesh as statutin e as me ligjin dhe mundeni të aprovoni.

**Nënkyetari** – Unë e çmojë lartë profesionalizimin e zonjës së nderuar, por pak ram ndeshë në këtë rast, ose nuk keni deshtë të thuani qartë këtë definim rrëth rregullores të sistematizimit ose me qëllim e keni bërë, është çështje tjetër, vetëm hyri në nenin 1 qëllimin e rregullores ku ju tregon se për çka është. Kjo rregullore nuk ka të bëjë asgjë me sistematizimin dhe pëershkrimin e vendeve të punës e të gjithë zyrtarëve në komunën e Rahovecit, kjo është rregullore e cila organizon administratën e komunës së Rahovecit në njësitet organizative të cilat duhen të përbahen sipas ligjit në sektorë dhe njësi, ndërsa katalogu vjen ma vonë dhe pastaj fillon procesi i rregullores mbi sistematizimin dhe pëershkrimin e vendeve të punës. Ju garantoj se brenda muajve ne do vijmë në atë situatë që tërë statutin e komunës ta ndryshojmë përsye se rrëthanat janë dita ditës duke ndryshuar.

**Qazim Qeska** – Në qoftë se ekzekutivi i komunës së Rahovecit kuptohet me kompetentet e sektorit ligjor dhe i kanë servuar Kuvendit këtë akt normativ dhe ne në statut kemi thënë se këtë akt do ta rregullojmë me rregullore, atëherë në kuadër të mundësive të mia si jurist konsideroj se kjo rregullore në formë dhe përbajtjen çfarë në është servuar mund t'i shërbej administratës komunale në mënyrë perfektë, ngase ka mbështetjen edhe në ligjet e aplikueshme që janë cekë në hyrje të rregullores. Do të ishte mirë nëse ka propozime konkrete në formë të amendamenteve, kishte qenë mirë t'i kemi këtu dhe të deklarohemi. Por sidoqoftë unë konsideroj se përbajtja normative është fleksibile dhe do t'i shërbej ekzekutivit për të qenë në shërbim të detyrate që i jep LVL. Në dispozitat përfundimtare është e cekur se pjesa që ka të bëjë me sistematizimin e punëve dhe detyrate do të bëhet me një akt tjetër duke ju përbajtur katalogut. Unë kam pas raste të njoftohem me aktet e tillë të disa komunave dhe besoni se nuk ka kurrfarë dallimi rregullorja për organizimin e brendshëm që ne këtu e kemi me rregulloren të shumë komunave tjera. Kam një pyetje për hartuesit e kësaj rregullore, nuk jam duke e kuptuar se çka kanë deshtë të thotë në nenin 3 paragrafi 3.2 organogrami i komunës është pjesë përbërëse i kësaj rregullore, dua ta di se a ka organogram komuna dhe nëse ka le të më thotë dikush. Duhet të jetë organogrami i administratës dhe jo organogrami i komunës sepse komuna e ka organogramin me 3 pjesë, Kuvendin, Kryetarin dhe Administratën dhe propozoj që ky gabim të përmirësohet.

**Azbi Gashi** – Edhe ne si Lëvizje Vetëvendosje kemi dhanë qysh në statut arsyet dhe po ashtu jemi kundër edhe kësaj rregullore, arsyaja është për shkak se kompetencat i kalojnë drejt përdrejt kryetarit.

**Florije Boshnjaku** – Më vjen mirë që kolegët e mi në mënyrë indirekte e thanë atë që e thash unë, sepse shumë qartë e tha se organogrami i bashkëngjitet kësaj rregullore dhe çka është organogrami.

**Kryesuesi** – E qesë me këtë plotësim rregulloren në aprovim? Me 16 vota për, 8 kundër dhe 1 abstenim, konstatoj se është aprovuar Rregullorja për organizimin e brendshëm.

#### 4. Shqyrtimi dhe aprovimi o propozim Vendimit për shpalljen e interesit publik për shpronësimin e pronës private për nevojat e shkollës filllore “Ardhmëria” në Rahovec,

**Kujtim Popaj**, drejtori për kadastër – Kemi të bëjmë me shpronësimin e një parcele me Nr.1552 me sipërfaqe prej 45 ari e 54 m<sup>2</sup>, e cila gjendet afër shkollës filllore “Ardhmëria” në Rahovec. E gjithë kjo ka ardhur me kërkesën e Drejtorisë së arsimit e cila ju ka drejtuar kryetarit të komunës për rritjen e sipërfaqes të kësaj shkolle për ndërtimin e një fushe sportive ose sallë të sportit për nevojat e nxënësve. Ne si Drejtori i kemi bërë të gjitha përgatitjet, kjo pikë është shqyrtuar edhe në KPF dhe e ka mare aprovimin e po ashtu ju kisha lutar edhe juve që ta aprovoni këtë vendim në mënyrë që Drejtoria përkatëse të merret me procedurat e mëtutjeshme për

shpronësimin e kësaj ngastre. Ne si Drejtori do të veprojmë sipas Ligjit për shpronësim, prona është private e kam edhe listën poseduese dhe kopjen e planit, dhe sa kam unë informatë edhe pronarët janë të pajtimit ta bëjnë shitjen e kësaj prone, e që janë 3 vëllezër, Sreçko, Vekosllavi dhe Zhikica Milenoviç dhe pa marrëveshje nga dy palët nuk mundet të shpronësohet.

**Selim Duraku** – Ne në emër të grupit të LDK jemi pro këtij vendimi dhe besojmë se është një vendim i qëlluar sepse kjo shkollë ka një hapësirë shumë të vogël dhe ju përgëzojë për këtë vendim.

**Ejup Kabashi** – Më vjen mirë që Drejtoria e arsimit së bashku me drejtorin për kadastër po mendojnë për zgjerimin dhe hapësirë nëpër shkolla, por unë sot nuk e di se çka do të aprovojmë përpos një vendimi dhe një leje që do ta autorizojmë drejtorin për kadastër, unë nuk jam duke e parë koston e kësaj dhe si do të ekzekutohet kjo, në çfarë formë, a do të jetë bartëse e gjitha shpenzimeve komuna, nuk e kemi të qartë, unë do të jem gjithsesi pro këtij vendimi.

**Kryesuesi** – Forma e shpronësimit të pronës me ligje bëhet me anë të një komisioni qeveritar, ata e vlerësojnë vlerën e pronës, ndërsa pagesën e këtij shpronësimi e merr përsipër komuna, pronarët e kësaj prone e kanë caktuar çmimin dhe shpresojmë se komisioni do t'ja qëlloj me këtë çmin.

**Florije Boshnjaku** – Ajo që është ma kryesorja për këtë vendim mungon kërkesa e Drejtorisë për arsim, dhe ne duhet të dimë sa do të kushtoje kjo dhe a ka mjete komuna. Kur shpallet interes i përgjithshëm për ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve a do të bëhet edhe për ata shqiptarë shpronësimi apo vetëm për komunitetin serb, pra ta dimë se a ka mjete komuna për t'i paguar gjitha këto shpenzime edhe për raste tjera apo kemi vetëm për një rast.

**Kryesuesi** – Ne sot jemi duke biseduar për këtë raste sa i përket se a ka komuna për rastet e tjera e dinë ata. Ju e dini se kjo shkollë çfarë hapësire ku nuk ka as parking për vetura dhe mendoj që komuna ka bërë mirë që ka marr vendim për ta bërë këtë shpronësim dhe besoj se ka mundësi për ta bërë kompozimin, ndërsa sa i përket rrugëve unë sa e di ku ka pas nevojë janë shpronësuar, përpos rasteve ku ka pasur të hapet një rrugë e re dhe bashkëpronaret janë pajtuar që të hapet pa kompozim.

**Fatmir Iska** - Ne jemi të pajtimit dhe do ta përkrahim këtë propozim vendim për ndërtimin e sallës se me të vërtet kësaj shkolle i nevojitet. Kam disa pyetje për drejtorin, pronarët që janë prezantuar në këtë vendim a janë në jetë dhe nëse nuk janë njëherë duhet të kryhet trashëgimia e pastaj të bisedohet me trashëgimtarët e tyre dhe a janë të pajtimit për këtë shpronësim, duke e ditë se këtu është një pronë e cila për një ari çmimi besoj se nuk është edhe i lirë dhe sipërfaqja është 45 ari ku do të jetë një kosto goxha e madhe për komunën. Sa e di buxheti komunal për shpronësimë është diku 85.000 € dhe e gjithë kjo shumë do të shkoj për këtë. Po ashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e arsimit se a ka ndonjë projekt për ndërtimin e sallës, dhe siç e dimë e gjithë kjo shkollë është ndërtuar me donacione pse të mos të kërkohet donacion edhe për këtë sallë.

**Rasim Fazliu** – Po ashtu edhe unë e mbështesë iniciativën e kryetarit të komunës që këto parcela t'i shpall interes publik, sa i përket shkollës "Ardhmëria", të gjithë e dinë si nxënësit si mësimdhënësit janë të ngulfatur dhe besoj se kjo është në gjë e mirë. Unë edhe në KPF e kam cek që kjo është jashtëzakonisht një punë e mirë, por vetëm duhet të vije deri tek zotimi i mjeteve dhe të realizohet kjo. Dua të ceki se këtu po flitet për shpalljen e interesit publik për zgjerimin e oborrit të shkollës "Ardhmëria" në Rahovec e në pikën 3 thuhet që Kuvendi i komunës ma vonë do të iniciojë procedurat e marrjes së vendimit mbi shpalljen e interesit publik dhe inicimin e procedurës për shpronësimin e pronës të paluajtshme të cekur ma lartë. Duhet të dihet se propozimet për shpronësim i jep kryetari i komunës e jo drejtorët, por është diçka tjetër se kënd e autorizon kryetari. Ne si grup i PDK e mbështesim këtë propozim vendim.

**Kujtim Popaj** – Fatmiri pyet se personat që janë pronarë a janë të gjallë. Me tregu të drejtën unë nuk e di por besoj se këto janë çështje teknike të ekzekutivit dhe e do t'i rregulloj duke u bazuar në ligjet në fuqi.

**Fatmir Iska** – Sa po kuptoj ju nuk keni biseduar me këta pronarë, po çka nëse këta pronarë kanë nxjerr leje urbanistike dhe mbasse një javë do t' ja fillojnë ndërtimin e shtëpisë, ju po e shpallni interesin e përgjithshëm pa e diskutua këtë punë me askënd.

**Kujtim Popaj** – Ky është hapi i parë se përndryshe ka procedura tjera deri sa të arrihet marrëveshja finale, dhe unë besoj përderisa Drejtoria e arsimit e ka sjell këtë vendim në Kuvend besoj se ekziston një farë vullneti.

**Kryesuesi** - E qesë në aprovim këtë pikë të rendit të ditës? Konstatoj që në mënyrë unanime është aprovuar ky propozim vendim.

**5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim Vendimit për shlyerjen e borxheve 50% e të gjithë qiramarrësve të pasurisë komunale.**  
**Avdullah Kryeziu**, drejtori i ekonomisë - Ky vendim është marr duke u bazuar se të gjitha bizneset në komunën e Rahovecit ballafaqohen me shumë vështirësi dhe bariera serioze të cilat pengojnë funksionimin e aktiviteteve të tyre të përditshme. Komuna nuk ka ndonjë fond të posaçëm përmes shtëpiëve e bizneseve për shkak të buxheteve të limituara, po ashtu duke u bazuar në papunësinë e cila është mjaft e madhe në gjithë Kosovën. Duke u bazuar në kërkësën e një grupei të bizneseve për shlyerjen e borxheve të lokaleve afariste në Rahovec, problemet të cilat i kanë shfaqë ata janë, konkurenca jo lojale e të bërit biznes, ngitura e pikave të fuqishme në Rahovec si ETC dhe Super Viva, rrënja e fuqisë blerëse të popullatës, papunësia e madhe, në emër të kryetarit të komunës dhe Drejtorisë së ekonomisë, zhvillim dhe turizëm e cila mbikëqyr bizneset në komunën e Rahovecit ju propozojmë juve që bizneset të cilat kanë lokale me qira hapësirat e brendshme t'ju shlyhen borxhet për 50% të borxhit aktual. Unë kam disa propozime konkrete rrëth këtij vendimi, në pikën 3 ku thuhet se obligohen të gjitha shfrytëzuesit e lokaleve afariste që janë pronë e komunës që të paguajnë paraprakisht 50% të borxhit me qëllim të shlyerjes së borxhit të tërësishtë që ti shtohet edhe një afat kohor prej 3 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Po ashtu edhe tek pika 6 ku thuhet se ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas miratimit nga kuvendi komunal të zëvendësohet me fjalinë ky vendim hynë në fuqi pas shqyrtimit të ligjshëmisë nga MAPL-ja.

**Lirih Berisha** – E përkrahi këtë vendim të drejtorit për ekonomi dhe turizëm, mirëpo unë kisha dhanë një propozim ato firma që kanë krijuar borxhe deri në 48,000.00 në qoftë se brenda 3 muajve nuk i paguan borxhet të hiqen nga lokali.

**Selim Duraku** – Mirë e keni bërë që i keni kufizuar që një herë duhet t'i paguajnë 50% e pastaj të i shlyhen borxhet. Po ashtu e përkrahi edhe parafolësin që tha t'i jepet një afat prej 3 ose më shumë muajve sepse është një ndihmesë që bizneset e vogla të shkojnë ma tutje.

**Ejup Kabashi** – Edhe unë e përkrahi këtë vendim përfaljen dhe shlyerjen e borxheve pre 50%, por mua më shqetëson fakti sapo isha duke e shikuar listën e borxheve dhe e pashë që një këpucëtar që ka një hapësirë të një lokalit dhe borxhet e tija figurojnë zero, ndërsa Samir Myftarit i jepet gjithë ajo pronë nga Kuvendi dhe i ka borxhe 18,000.00 €. Unë kisha propozuar që këtij të mos i falet borxhi por me përcjell punën e investimeve sepse ka premtuar 2 milion € investime. Duhet të kemi kujdes çka do të bëjmë me këta që kanë qenë

pagues tē rregullt tē qirasë dhe borxhet e tyre janë zero dhe mos ti japim lëmoshë bizneseve tē papërgjegjshme aq shumë. Pajtohem plotësish me Lirihun ndoshta afati prej 3

muajve është i shkurtë por ti jepet një afat pak ma i gjatë, dhe nëse nuk e shlyen borxin pre 50 % tē hiqen nga lokal i dëgjohet dikujt që do tē jetë pagues i rregullt i tatimeve ndaj komunës.

**Florije Boshnjaku** – Në lidhje me këtë propozim vendim edhe unë kam propozuar në këtë Kuvend që tē lirohen bizneset me 50 % tē falen borxhet, por ju jeni deklaruar se i ka falë Qeveria e Kosovës. Propozimi im është që tē caktohet një nen se në cilin afat i falen borxhe, a ju falen deri me 31 dhjetor 2014 apo edhe tē vitit 2015, dhe pajtohem me parafolësit që ti jepet një afat dhe propozoj që ti jepet afat deri me 30 shtator 2015, sepse ai që ka shumën e madhe tē borxhit nuk mund tē paguaj 50% pér një herë.

**Rasim Fazliu** – Po ashtu edhe unë e mbështesë këtë propozim vendim sepse është mirë t'i dilet në ndihmë bizneseve, por është një padrejtësi pér ato bizneset që i kanë likuiduar tē gjitha borxhet dhe sigurisht se ata do tē shfaqin pakënaqësi. Po ashtu edhe në KPF e kam cek se ndoshta është një praktik e keqe në tē ardhmen sepse bizneset mundë tē mos paguajnë prapë do mendojnë se prapë do na shlyhen borxhet. Është mirë që ti përmbahen afatit prej 3 muajsh si e propozoj drejtori në atë mënyrë ai që i paguam 50% tē borxheve e vazhdon punën dhe i shlyhen 50% tē tjera nga ana e Komunës.

**Nënkyetari** – Kisha me ndërhy pak se jam duke e parë që diskutimi është duke e marr kahen e vetë dhe nuk jeni duke e përkufizuar dhe po ashtu ju delegatë po më duket nuk jeni duke i shikuar fare dokumentacionet. Unë në emër tē kryetarit përkufizohem, nuk është propozimi i kryetarit pér gjithë bizneset por vetëm pér lokalet afariste që nuk kanë dalë në ankand dhe janë duke punuar vetëm me vendim pa kontratë, pra vetëm pér dyqanet.

**Ejup Kabashi** – Z. Nënkyetar ju po thoni se ne nuk jemi duke i lexuar neve na ka ardh ky material sot dhe jemi duke e lexuar dhe mos na thoni neve si tē pa ditshëm dhe tē pa lexueshëm, por gabimet e juaja përmirësoni ju sepse neve na ka ardhur një listë e borxlinjve dhe ne jemi duke u marr me këtë listë.

**Kryesuesi** – Edhe në KPF kemi thanë vetëm pér lokalet, po ashtu ka qenë propozim edhe i delegatit Rexhep Oruçi, ndërsa pér ndërmarrjet siç është Hoteli dhe Matrixi në Xërxa këto do i bëjmë me një vendim tjetër tē veçantë, dhe tē gjitha ata që kanë një plan tē biznesit që mundën tē hapin vendet e punës do i falim edhe ma shumë se 50%, pra kjo vlen vetëm pér lokalet afariste që janë dhënë me qira që janë në qytet.

**Rexhep Oruçi** – Ky vendim thotë tē shlyhen borxhet pér 50% pér tē gjitha bizneset që kanë lokale me qira dhe që janë pronë e paluajtshme e komunës, më këtë formulim nuk ka përkufizime tjera sepse tē gjitha objektet janë me qira, qoftë me kontratë qoftë me tender.

**Fatmir Iska** – Unë defenitivisht nuk e kuptoj këtë ekzekutiv e më së paku Nënkyetarin e komunës i cili don t'ja gjuaj fajin Kuvendit pér gabimet që ai vetë është duke i bërë, por e ka gabim. Përse na është servuar kjo listë nëse nuk është ashtu si ju thoni, ju po tentoni t'na mashtroni anëtarët e kuvendit komunal sepse në këtë listë i kemi tē gjithë 26 biznese, 20 janë me ankande ndërsa 6 tē tjerë me kontratë, 13 prej 26 janë pagues tē rregullt dhe 13 tē tjerë janë që kanë borxhe. Shembull me numër vendor 3 Qani Mullabazi NT Ganex 144 m<sup>2</sup>, borxhi total 48,450.00 € dhe këtij nëse i falet 50% atëherë këtij i bie tē paguaj 24,225.00 €, që do tē thotë para tē gatshme duhet ti paguaj komunës. Jam i sigurt që nëse ky kishte me pas këto pare ai kishte me qenë edhe pagues i rregullt i qirasë. Shkojmë tek numri vendor 17 Kompania Ila – H 30 m<sup>2</sup> me ankande, borxhi total aktual 950.00 € dhe këtij nëse i falet 50% e borxhit i mbësin vetëm 475.00 €. Ku është krahasimi ndërmjet këtyre dyve, është një krahasim shumë i madhe duhet tē keni parasysh. Çka do tē thonë këta pagues tē rregullta a minden edhe këta pagues tē rregullt me paraqitë kërkësë këtij Kuvendi me i kërkuar ato mjete që ata i kanë paguar përderisa këtyre tjerëve po i shlyhen borxhet prej 50%. Pra ne do tē jemi tē detyruar që ta miratojmë edhe kërkësën e tyre ose t'i kthehen mjetet ose tē kompensohen pér ata shumë që kanë paguar. Thjeshtë me këtë listë që na është afruar kanë dashtë t'na mashtrojnë edhe pse votën time unë do ta japë pér shlyerje e borxheve, por prap e them nëse ka kërkësë nga ndonjë pagues i rregullt i qirasë unë prapë do ta japë votën pér që t'i kthehen mjetet ose tē kompensohen me ndonjë formë tjetër. Kam një pyetje pér drejtorin nëse nuk paguhen këto borxhe prej qiramarrësve cilat veprime ose procedurat do tē ndermirën më tutje. Pyetje pér drejtorin, në 2016 prapë mundë tē kemi një kërkësë tē tillë nga kryetari ose nga qiramarrësit që minden tē mblidhen dhe t'i drejtohen Kuvendit dhe mund tē kërkojnë prapë shlyerje tē borxheve në këtë përqindje që e kemi tanë, dhe nëse i marrim këto borxhe tē mëdha prapë i bie gjysma dhe çka bëjmë ne pér 3-4 vite vvetveti minusohet në krejt borxin total që e ka.

**Azbi Gashi** – Unë jam kundër që t'i shlyhen borxhet, pér arsy se disa firma shumë tē vogla i kanë shlyer borxhet ndërsa disa firma fitimprurëse kanë borxhe shumë tē mëdha dhe unë jam kundër që t'i zbritet borxhi prej 50%.

**Rasim Fazliu** – Që në fillim e thashë, është mirë tē ndihmohen bizneset dhe pajtohem plotësish me Ejup Kabashin që ky mos sqarim nuk vije nga ne por nga ekzekutivi. Ne nuk mundemi me ditë se çka mendon ekzekutivi, por ne vetëm dimë tē lexojmë këtu çka shkruajnë, prandaj tē gjitha ato mos sqarime janë dashtë tē shkruhen në letër dhe ne i kishim lexuar tamam ata si kanë menduar. Unë mendoj se është mirë ne tē marrim një vendim, mirépo para se ma marr këtë vendim pér shlyerjen e borxheve tē precizohet që kjo kategori e bizneseve lirohet dhe kjo jo sepse përndryshe kështu nuk mundemi tē shkojmë përpëra.

**Bahtjar Hoti** – Unë nuk i kam tē qarta kriteret që i ka komuna pér mbledhjen e borxheve, a i ka harxhuar komuna si mjetë në raporte me ta dhe ka ardhur në përfundim që tē shlyhen 50% tē borxheve. Dua ta di se cila është përgjigja, dhe këtu nuk është e specifikuar se pse këto biznese nuk e kanë larë borxin. Ne jemi pér me i ndihmuar bizneset dhe kemi votuar pér me i dalë në ndihmë, por nuk ka ndonjë sqarim se pse me i ndihmuar, a me tē vërtet janë tē lodhur apo është ndonjë zyrtar i lartë i lidhur direkt me ta.

**Selim Duraku** – Unë jam edhe anëtar i komisionit pér ankande publike. Ne në mbledhjen e kaluar kemi cekë se tē gjitha bizneset që kanë me dalë në ankand publik, si kriter ka qenë shlyerja e borxheve. Tash ka ardh një vendim nga ekzekutivi që tē shlyhen 50% borxhet. Këtu ne e kemi një listë me tē gjitha bizneset që kanë me dalë në ankand, dhe nënkyetari nuk ka nevojë tē ja lejë fajin Kuvendit sepse pika e parë thotë tē shlyhen borxhet 50% e tē gjitha bizneseve që kanë lokale me qira dhe që janë pronë e paluajtshme e komunës së Rahovecit.

**Bahtjar Hoti** – A ka mundësi me shty pér mbledhjen e radhës dhe me dhanë një pasqyrë tē saktë e jo siç po e jepni sot copëza copëza, pra kompletoni pér mbledhjen e ardhshme, por siç jam ka e shoh ju po dëshironi tē bëni sot votimin me çdo kusht.

**Avdullah Kryeziu** – Unë mendoj se anëtarët tē KPF që kanë qenë në mbledhje vërtet keni harruar se çka keni thënë ose ndoshta unë kam harruar. Vendimi ka qenë shumë i qartë, Rexhep Oruçi ka thënë kështu tē përfshihen edhe bizneset e tjera që janë me qira, ka

përmend edhe një fabrikë të letrës dhe hapësirat publike të jashtme. Ne i kemi thënë se ky vendim është për hapësirat e brendshme sepse hapësirat e jashtme nuk janë në kompetencat e drejtorisë time. Unë e kam bërë propozimin në konsultim me kryetarin e komunës, me bordin ekzekutiv nuk e kam mare këtë vendim vetveti.

**Rexhep Oruci** – Ti po thua drejtor se drejtoria juaj është kompetente për hapësirat e brendshme, rezerva materiale në Xërxë a është e jashtme apo e brendshme, specifikimi dhe ndarja nuk është bërë si duhet më mirë, të kishit thanë zanateve të vegjël po i falim borxhet 50% dhe jo për biznese të tjera.

**Kryesuesi** – Në KPF ka qenë shumë e qartë dhe jemi dakorduar që bizneset në Matrex dhe Hotel Parku, me qenë me një vendim të veçantë. E qesë në votim kush është që të shtyhet për mbledhjen e radhës? Në mënyrë unanime është votuar për shtyrjen e pikës së 5 për mbledhjen e radhës.

**6. Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës të OJQ “EKSODI 99”. Kryesuesi** – Është një kërkesë që eksodi 99 edhe ashtu prej pas lufte vazhdimisht organizohet në fshatin Xërxë. Është OJQ jo qeveritare e regjistruar me seli në Mitrovicë, kanë një Kuvend ku ku marrin pjesë edhe delegatë nga fshati Xërxë dhe kanë kërkuar që kjo mirëpritja Driniase që organizohet çdo vit prej datës 15 prill të mbahet çdo vit nën patronatin e kryetarit të komunës, pra ata kanë kërkuar që kjo të bëhet me një vendim nga Kuvendi komunal.

**Florije Boshnjaku** – Unë kam një pyetje për nënkyetarin ose kryesuesin e komunës, cili është propozimi i kryetarit të komunës dhe çka po mendon kryetari i komunës sepse ne nuk mundemi me ja imponu atij.

**Kryesuesi** – Ne vetëm gojarisht kemi fole me kryetarin e komunës edhe ai është pajtuar por propozim nuk ka në mënyrë të shkruar. Unë e qesë në votim? 13 për, 3 kundra, 6 abstenime.

**7. Shqyrtimi i Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa. Kryesuesi** - drejtori do të na jep shkurtimisht sqarime se ku ka pasur mos harmonizime të taksave me udhëzimet e nivelit qendror.

**Avdullah Kryeziu** – Komisioni i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe MAPL lidhur me Rregulloren e cila është miratuar në Kuvendin komunal i ka dhënë disa vërejtje dhe sugjerime konformë ligjit. Unë disa herë kam kërkuar nga ju që t'i përbahemi udhëzimeve administrative dhe ligjeve që janë në fuqi, mirëpo disa propozime kanë qenë jo konform udhëzimeve dhe ligjeve në fuqi dhe ata kanë kërkua që kjo rregullore të harmonizohet. Kanë dhënë vërejtje tek neni 5 tek **ligji i ndërtimit**, por edhe ata në Ministri nuk i kanë disa gjëra të qarta sepse drejtori i urbanizmit ma herët e ka dërguar shkresën zyrtare se tarifat e kësaj Drejtorie a janë konform ligjit dhe përgjigjja ka qenë pozitive. Tek neni 10 pika 2 tek Drejtoria e bujqësisë dhe pylltarisë dhe zhvillimit rural. Këtu ka pas kërkesa përritjen e taksës për shndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore, por nuk i keni shikuar udhëzimet administrative sepse në udhëzime administrative janë të përcaktuara tarifat, ndërsa pas rritjes që na i kemi bërë në kuvend ata kanë reaguar dhe kanë thanë ju lutem veproni konformë udhëzimeve administrative dhe ne kemi vepruar dhe kemi harmonizuar konformë udhëzimeve administrative. Tek Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenies sociale po ashtu ka pas rritje të taksave dhe na kanë detyruar që ti kthejmë taksat si janë me udhëzim administrativ dhe me ligj, edhe kjo është kryer. Tek neni 22 i rregullores kanë dhënë vërejtje rreth taksave, fillimisht kanë qenë taksat për ushtrimin e veprimtarisë afariste, kanë qenë të precizuara ndryshe dhe ata na kanë kërkuar që kjo të bëhet konform ligjit, rregullorja e cila ka kaluar në kuvend. Ka qenë taksat ngarkesat për publikimin firmës për veprimtarin afariste, ndërsa duhet të jetë takset ngarkesat vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, pra në terminologji kemi gabuar por edhe këtë e kemi rregulluar. Tek Drejtoria për ekonomi, për depo shtëpi të malrlave, oficinat, servisimet, garazhet, ndërmarrjet prodhuese, prodhuesit e piyeve alkoolike ngarkesat kanë qenë në m2 kjo është kthyer dhe na kanë thanë se duhet të janë tarifat fikse në bazë të llojit të veprimtarisë. Po ashtu kemi pas edhe tek neni 26.4 ne kemi thanë se pala kur është e pakënaqur me këto taksa dhe ngarkesa mund t'i drejtohet komisionit të përbashkët MF dhe MAPL, ndërsa ata na kanë thanë të hiqet nga rregullorja neni 26.4 sepse nuk ekziston Komisioni i MF dhe MAPL për shqyrtimin e ankesave të palëve dhe ne e kemi hekë. Pra këto kanë qenë vërejtjet dhe sugjerimet dhe ata na kanë kërkuar që brenda afatit të caktuar të bëhet harmonizimi i rregullores dhe unë ju kisha propozuar juve që kjo Rregullore të miratohet si tërsë i jo ndarës sipas vërejtjeve që i ka dhanë MAPL, pastaj na mbetet ta dërgojmë edhe një herë në MAPL dhe të certifikohet.

**Rasim Fazliu** – Mua më kujtohet mirë ne kur e kemi miratuar këtë rregullore kemi thanë se në qoftë se bie ndesh me ligjet, ju keni të drejtë vet që ti përmirësoni ato dhe ti dërgoni prapë në MAPL që mos të na bini neve fare vë kuvend.

**Kryesuesi** – Ata na kanë thanë se çdo ndryshim që bëhet duhet të kaloj prapë në Kuvend. E qesë në votim kush është për aprovimin e kësaj Rregullore me këto ndryshime? Me 1 abstenim dhe të tjerët pro është aprovuar Rregullorja për taksa, tarifa dhe ngarkesa me këto përmirësimë që janë bërë.

**8. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve. Kryesuesi** - Ka mbetur emërtimi i rrugëve, rrugicave dhe shesheve peng i një peticioni që e kanë bërë disa banorë të fshatit Ratkoc të cilët nuk janë pajtuar me disa emërtime. Ne i kemi ftuar një ditë përfaqësuesit e fshatit dhe jemi dakorduar dhe po ashtu i kemi 2 kuvendarë nga fshati Ratkoc dhe i kisha lutë që ata të na ndihmojnë dhe të bëjmë një harmonizim të këtyre emërtimeve dhe të përfundojë kjo çështje sepse jemi komuna e vetme që ende nuk e kemi kryer këtë punë.

**Bahtjar Hoti** – Kur është caktuar kriteri për emërtimin e rrugëve mendoj se një pjesë të fajit e ka kryetari i komunës dhe kryesuesi që kanë lejuar që të ndërhyhet në këtë proces. E kërkova listën e emërtimit të rrugëve sepse edhe në komision kemi bërë ndryshime, por lista nuk është ndryshuar ashtu si jemi marr vesh në mbledhje të komision. Kur është emëruar komisioni për emërimin e rrugëve dhe shesheve në atë kohë. ju e dini mirë e keni votuar propozimin për biografin e secilit që e merë emrin rruga, disa ju kanë përbajtur kësaj dhe i kanë pru. Tash do i ceki disa ndryshime që janë bërë Nezir Qerim Hotin e zëvendëson emrin e Martin Camajt, Vesel Zenel Hoti e zëvendësohet me emrin Thana e Bardhë. Me kërkësen e lagjes së Hajdarbegajve është ngjitur emri Hajdar Beqa duke e zavendësuar emrin e Fazli Hotit, Valon Idriz Hoti e zëvendëson Ibish Osmanin. Po ashtu e kemi lagjen Shala dhe Hoti, kanë propozuar që Qamil Morina të zëvendësohet me emrin Batalioni i Tretë. Tash do e propozojmë edhe emrat rezervë, të lagjes Shala, Hoti dhe Morina që është e emërtuar rruga Agron Rahmani dhe këta më kanë thënë nëse mundet le të mbetet edhe emri Agron Rahmani sepse është dëshmor. Pra, hiqet emri Agron Rahmani dhe zëvendësohet me emrin e Sadik Shalës, aty ku ka qenë Batalioni i tretë emërohet me emrin Vëllezërit Lleshi, aty ku ka qenë Vëllezërit Lleshi emërohet Smajl Haradinaj, ndërsa aty ku ka qenë Smajl Haradinaj emërohet Qamil Morina, aty ku është Fadil Morina të zëvendësohet me Bahri Fazliu sepse dy mbledhjet e komisionit kemi diskutuar dhe nuk është nderuar. Në vend të Medlin Olbrajtin e qesim Shkelzen Hotin, po ashtu hiqet Haki Hoti dhe ngjitet Fazli Hoti. Tash e kemi Agron Rahmani emrin rezervë, Muhamet Ilazin, Haxhi Mala.

**Kryesuesi** – Unë jam që të ketë një kompromise tek banorët e fshatit dhe jo nesër me vendos tabelat dhe ata familjarë të pakënaqur të i heqin emrat e dëshmorëve, dhe është mirë që është arritur një kompromis dhe janë bërë disa lëvizje të kodeve dhe janë shtuar disa emra të rinj dhe këtu nuk ka asgjë të keqe, kërkoi nga ju që të aproponi këtë propozim ndryshim të emërtimit të rrugëve të fshatit Ratkoc.

**Florije Boshnjaku** – Në lidhje me këtë çështje kur kemi diskutuar pikërisht unë kam thënë se nuk do të pajtohen lagjet me këto emra. Ti ke thënë kush i pyet lagjet sepse ne jemi organ më i lartë, pra kush është ai që dikujt ju është ngjitur emri i ndonjë dëshmori dhe familja ka dëgjuar dhe e largon pa kurrfarë arsyetimi. Kjo për mu nuk është në rregull, ne jemi duke luajtur me personalitetin e njerëzve, së pari ti si kryesues e as kryetari i komunës nuk duhet ta lejoj këtë të ndodhë.

**Ejup Kabashi** – Unë pajtohem plotësisht me Florijen, dhe nuk e di se pse ne e kemi paguar atë komision. Ne në Kuvend e kemi aprovuar një vendim dhe unë ku kam pas vërejtje përfshatin tim, kam dalë me propozime konkrete dhe kam dhënë arsyetime konkrete sepse duhet të hiqet ky emër dhe pse duhet të jetë ky emër tjetër, dhe mua më vije shumë gjynah sepse Agron Rrahmanit nuk kam vend se sot ja kisha ngjitur një rruge në fshatin tim. Nuk e di se a munden me analizuar ata njerëz se kush ka qenë ai dhe se nuk patën arsyetim Ratkoci me i ndërruar gjithë këto emra, sido që të jetë unë jam që të zgjidhet problemi dhe të gjendet një farë mjedisi.

**Fatmir Iska** – Unë nuk mundem me qenë kundër vullnetit të atyre qytetarëve që e kanë pru atë peticion, unë nuk e di begraundin e atyre njerëzve përpos Agron Rrahmanit që kam dëgjuar. Mirëpo, prapë është çështja që ne duhet me i respektua vullnetin e atyre njerëzve që dëshirojnë me i ndryshuar, sepse janë ata të atij vendbanimi. Ne kemi marr një vendim në Kuvend dhe sa është e ligjshme që prapë të vendosim përfshimin e njëjtë unë nuk e di dhe mendoj se tash jemi në pikën pyetjet dhe përgjigjet.

**Kryesuesi** – Është e rrugës që Kuvendi ta ketë nga një biografi për secilin që i vihet emri i ndonjë rruge që ta dimë se kush ka qenë por ju këtë nuk e keni bërë.

**Mirjeta Krasniqi** – Kush më pak dhe kush ma shumë të gjithë kanë kontribuar në atë fshat dhe mendoj se ju takon vet fshatit të vendosë me vullnetin e tyre se si do të quhen ato rrugë. Një pjesë e fshatit e kanë pa se duhet të bëhet një ndryshim dhe e kanë sjellë peticionin. Po ashtu edhe unë e kam parë se nëpër fshatra ka shumë ankesa, sepse ka emërimë diku vend e pa vend, diku 2 anëtarë prej një familje, dhe mendoj se banorët e atij fshati kanë më shumë të drejtë se na të vendosin se si do të quhen rrugët dhe lagjet e tyre, unë e përkrahi kolegut Bahtjar Hoti.

**Bahtjar Hoti** - Së pari kolegia Mirjeta nuk ka nevojë përfshirë se nuk ka kundër këtij ndryshimi që është bërë, nuk e di se sa më ke kuptuar. Tjetra unë e kam shikuar procesverbalin kur kemi vendos përfshirë Komisionit përfshirë emërimin e rrugëve dhe shesheve dhe decidivisht aty shkruan se duhet të përshkruhet biografia dhe të vlerësohet se cila është më e begatshme. Po ashtu i kam thënë kryetarit mos bëni ndërrhyrje në institucion nga një grup njerëzish, kemi mundur të bëjmë ndryshime 1,2,3 emra e jo ma shumë, por ma interesante është se secili në lagje të vet la dëshirë ta ketë emrin e dikujt të afërt, dhe përfshirë më respekt kur e ka emrin në ndonjë lagje tjetër. Mendoj se kriteret janë shkelur dhe ky kompromis ka shkelë punën e Komisionit dhe të Kuvendit që ka marr vendimin.

**Besnik Hoti** – Unë mendoj se peticionin e qytetarëve duhet ta përkrahim, nëse ne jemi të zgjedhur e popullit ata njerëz e kanë bërë një kërkës dhe na u kanë drejtuar neve, dhe ne duhet që t'i kthejmë në mënyrë të drejtë. Nëse ata mendojnë se këtë rrugë duhet të ndryshohen atëherë le të ndryshohen dhe ju lus të gjithëve që t'i përkrahin këta qytetarë.

**Kryesuesi** – E qesë në aprovime kush është përfshirë fshatit Ratkoc? 13 përfshirë, 6 kundër, 1 abstenim.

**Rasim Fazliu** – Kryesues je duke e shkelur goxha si shumë Regulloren e Kuvendit dhe në mënyrë shumë shoqërore tu kisha latur që të mbash rendin ashtu si duhet, dhe qëdo ndryshim që duhet të bëhet ne e kemi dhënë mendimin që duhet të drejtobet tek komisioni dhe komisioni e qet në letër dhe ajo letër na shpërndahet neve kuvendarëve ku ne e shikojmë dhe e analizojmë dhe bëhet ndryshimi e jo kështu si po bëhet kjo praktikë.

**Kryesuesi** - Unë kam dashtë këtë punë ta qojë tek kryetari i komisionit, por kryetari i komisionit ka thanë se e kanë përfunduar punën në momentin kur është aprovuar në Kuvend.

**Rasim Fazliu** – Unë flas në emër të grüpuit tonë dhe propozoj që pyetjet të bëhen në fund të mbledhjes dhe përgjigjet të jepen në mbledhjen e radhës me shkrim dhe të futen në material. Tjetër, unë jam duke i përcjell vërejtjet e qytetarëve dhe ka raste që qytetarët shkojnë përfshirë zyre të vendit dhe ata i dërgojnë në Rahovec që ta merr një vërtetim që ka paguar tatimin në pronë dhe kthehu prapë që ta marrësh dokumentin. Propozoj që zyrat e vendit të njoftohen me listën e tatim paguesve përvit paraprak në mënyrë që mos t'ë maltrohet qytetari.

**Kryesuesi** – Unë sa e di dokumentet që nxjerrën në zyre të vendit nuk kërkohet më tatimi në pronë sepse është hequr, përndryshe ata mundën të hynë përmes internetit të shkojnë se kush ka paguar. Unë shqetësimin që e pat Rasimi e kam pas edhe si delegat sepse kur nuk na kanë përgjigjur me kohë, nëse pajtoheni është ma së miri pyetjet të bëhen me shkrim dhe ai detyrohet që ta kthejë me shkrim.

**Lirih Berisha** - Mendoj se mendimi i Rasimit nuk është kuptuar mirë, Rasimi tha se pyetjet bëhen në fund të qëdo mbledhje dhe përgjigjet bëhen në mbledhjen e radhës në pikën e parë të rendit të ditës.

**Fatmir Iska** - Unë pajtohem me ty kryesues që deri me tanë në 99.99% të rasteve të parashtrimit të pyetjeve asnjë përgjigje nuk kemi mare dhe askush nuk mundet të na mohoj neve se a dëshirojmë ti bëjmë pyetjet me shkrim apo me gojë ose nëpërmjet zyrtarit, është çështja e juaj ajo se çka bëni. Ne kemi dy mundësi që të bëjmë pyetjet edhe me shkrim edhe me gojë. Në komisionin përfshirë emërimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve, ne në seancën e shtatorit të 2014 kemi marr një vendim dhe kemi thanë kështu: Që ishte anëtarët e komisionit të paguhen me një shumë paushale ndërsa anëtarët e komisionit me mëditi prej 30 €, ndërsa në mënyrë të një anshme nënëkryetari i komunës që është shumë e ulët na heqë neve prej listës vetëm pse jemi nga radhët e partisë tjetër. Pra unë Fatmir Iska, Hazë Tara dhe Qemajl Krasniqi dhe kërkoi prej teje kryesues t'i zbatosh këto vendime përderisa i zbaton vendimet tjera. Kam një pyetje përfshirë drejtorin e administratës. Është formuar një komision përfshirë rishqyrtim të pranimit të punëtorëve që kap periudhën dhjetor 2010 deri janar 2014. Kërkojmë sqarim kur e dimë se në atë komision janë përfshirë pikërisht anëtarë të komisionit që janë pranuar në këtë periudhë. Dhe pyetja tjetër është përfshirë drejtorin e urbanizmit me na njoftuar përfshirë procesin e legalizimit se ku ka mbërrri.

**Kryesuesi** - Në mbledhje të radhës do të kërkojmë të gjitha komisionet që i ka formuar ky Kuvend me bërë raporte përfshirë tyre njëri prej tyre është që e ka kërkuar z Lirih Berisha, por me atë asgjë nuk është bërë.

**Lirih Berisha** - Unë nuk do të fjalosem me drejtorë, unë kam kërkuar raport dhe ata nuk më kanë dhënë. Të kam dërguar një letër që të intervenosh ti, por ti këtë nuk e ke bërë.

**Azbi Gashi** - Pyetje për drejtorinë përkatëse: rrëth trustit pensional, shuma është duke na u ndalur por atje nuk po na figuron, duam një raporte rrëth asaj.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 15.20.

Procesmbajtësi,  
Fahredin Sharku

Kryesuesi  
Nahit Elshani

